

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Gjuhë shqipe</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Shkrim akademik</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor – gjuhësi</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>me zgjedhje</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>II</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>1+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>4 ECTS (sipas planit 2010)</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Salla 88</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.asoc.dr. Bardh Rugova</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>bardh.rugova@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Shkrimi akademik përfshin shkathtësitë e të hartuarit për nevoja akademike, kundruar në dy rrafshë: normës së shkruar të shqipes dhe regjistrat nga njëra anë dhe norma e të hartuarit për nevoja akademike në kategori të ndryshme tekstore. Njëherësh ofrohen edhe koncepte të këndvështrimit folës dhe njësi bazike të kërkimit shkencor.</p> <p>Gjatë këtij kursi studentët do t'i mësojnë dhe do t'i ushtrojnë procesin dhe mënyrat e realizimit të shkrimit akademik mbështetur në teknikën hap pas hapi.</p> <p>Aftësia për të shkruar qartë dhe saktë është një kusht i domosdoshëm që duhet mësuar në shkollë. Çdo individ, pavarësisht shprehive apo njohurive të mëparshme, ka mundësi të mësojë të shkruajë mirë dhe ngjashëm me shprehitë e tjera, kërkon praktikë, përgatitje, organizim, përqendrim dhe përvojë.</p> <p>Të shkruarit e çfarëdo lloji të shkrimit nënkupton aftësi themelore të të shkruarit, njohuri të duhur të zbatimit të gramatikës si dhe një fjalor të pasur individual në mënyrë që të realizohen fjali dhe njësi të tjera themelore të një shkrimi të tillë. Një proces më thelbësor kognitiv do të duhej përfshirë ndërkaq për realizimin e shkrimit akademik. Gjatë orëve që do të mbahen në kuadër të kësaj lënde mësimore një proces i tillë do të elaborohet detajisht. Rrjedhimisht, ky kurs është më shumë i orientuar drejt një procesi në rend të parë e më pas drejt një rezultati që do të pasonte pas një procesi të përvetësuar mirë, prandaj të kuptuarit e drejtë dhe të sukseshëm të aktiviteteve që zhvillohen gjatë mësimin të këtij procesi do të jetë më i rëndësishëm se sa “prodhimi” i një eseje të</p>

	<p>formësuar mirë. Në këtë rrafsh nuk duhet harruar se shkrimi apo një punim i çfarëdoshëm akademik që konsiderohet të jetë prodhim final i një veprimtarie të disenjuar mirë me rregulla teorike dhe ushtrime praktike të po atyre rregullave është hiç më pak se reflektim i përpjekjeve të shumta të mësuara dhe të akumuluar mirë gjatë nxënies së procesit të shkruarit akademik.</p>
<p><b>Qëllimet e lëndës:</b></p>	<p>Ky kurs synon t'ua ofrojë studentëve shkathtësi të zotërimit të shqipes standarde shqipe dhe të rregullave të hartimit në tipa të ndryshëm teksti: rrëfyes, përshkrues, shpjegues, argumentues dhe udhëzues, duke i pasur parasysh regjistrat e përdorimit të gjuhës sipas fushave. Njëherësh, ofrohen edhe shkathtësi të leximit kritik, të përmbledhurit dhe të cituarit.</p>
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p>Në fund të këtij kursi, pritet që studenti të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta zhvillojë mendimin kritik dhe të realizojë lexime kritike të literaturës;</li> <li>- të përvetësojë (nxë) njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të shkruar në mënyrë akademike;</li> <li>- të dijë ta vendosë tezën brenda një teksti argumentativ;</li> <li>- të analizojë dhe të vlerësojë fuqinë e argumentit të shkruar;</li> <li>- të kuptojë konceptet themelore të hulumtimit;</li> <li>- të shkruajë në mënyrë efektive për audiencë të posaçme;</li> <li>- të mbështesë një qëndrim në mënyrë logjike, të rregullt dhe koherente;</li> <li>- të realizojë një diskutim retorik gjatë procesit të shkruarit;</li> <li>- të dijë si t'i sistemojë idetë dhe fragmentet e huazuara të tekstit sipas sistemeve ndërkombëtare të cituarit;</li> <li>- të përdorë me sukses gjuhën e shkruar letrare në të shkruar;</li> <li>- të njihet për së afërmi me realizimin e një prezentimi, qoftë ai prezentim me shkrim apo me gojë;</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	1 (45 min)	15	11,25
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	1 (45 min)	15	11,25
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2,5
Ushtrime në teren			
Kolokuiume, seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	25	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet, prezentimet ,etj	30 min	1	0.5
<b>Totali</b>			<b>92,5 orë</b> <b>92,5:25 = 3,7</b> <b>4 ECTS</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet punës praktike, kryesisht individuale, duke punuar mbi gabimet e secilit veç e veç. Si lëndë që kërkon shkathtësi, puna do të mbështetet mbi njohuritë paraprake të secilit individ dhe në përmirësimin e performancës nga java në javë.</p> <p>Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta. Studentët, kanë punime shtëpie që do t'i kryejnë në mënyrë të pavarur e që do të diskutohen dhe kontrollohen në orën e ushtrimeve.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10%</p> <p>Detyrat e shtëpisë (seminari) 60%</p> <p>Punimi final 30 %</p> <p><u>Gjithsej 100 %</u></p>		
<b>Literatura</b>			

<b>Literatura bazë:</b>	<p>Literatura e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Alice Oshima, Ann Hogue, Writing Academic English, Longman, New York, 1999</li> <li>- Qendra për Arsim Demokratik (përgatitur nga Bardhyl Musai), Si të shkruajmë ese, Si të shkruajmë një punim kërkimor dhe Si të shkruajmë – procesi dhe shkrimet funksionale, CDE, Tiranë, 2004</li> <li>- Kathleen E. Sullivan, Writing the Paragraph and the Short Composition, Macmillan Publishing Co., New York, 1980</li> <li>- Group of authors, The process of writing, Longman, NY, 1986</li> <li>- Cristopher Tribble, Writing, Oxford University Press, Oxford, 1996</li> <li>- Mary A. De Vries, A Handbook of Letter Writing and other forms of correspondence, Penguin Putnam Inc., NY, 2000</li> <li>- Donald Mulkerne, Gilbert Kahn, The Term Paper – Step by Step, NY, 1977</li> <li>- Umberto Eco, Si shkruaj, AIKD, Prishtinë, 2003</li> <li>- Sylvian Barnett, Pat Bellanca, Marcia Stubbs, Shkrimi akademik, DITA 2000, ISP, Tiranë, 2008</li> <li>- Njazi Kazazi, Irida Hoti, Merita Hysa, Shkrim akademik, Camaj-Pipa, Shkodër, 2007</li> <li>- Frank C. Harris, Mjeshtëria e të shkruarit profesional, Siprint, Prizren, 2003</li> <li>- Thomas S. Kane, Si të shkruajmë shqip?, CDE, Tiranë, 2010</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	-
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	- Java I: Hulumtimi shkencor dhe leximi kritik
<i>Java e dytë:</i>	- Java II: Përmbledhja e tekstit
<i>Java e tretë:</i>	- Java III: Parafrazimi dhe të cituarit
<i>Java e katërt:</i>	- Java IV: Të shkruarit si proces: të kuptuarit e detyrës, mbledhja e materialeve, skicimi, rishikimi dhe redaktimi
<i>Java e pestë:</i>	- Java V: Formimi i paragrafëve
<i>Java e gjashtë:</i>	- Java VI: Organizimi i paragrafëve:

<b>Java e shtatë:</b>	- Java VII Shkrimet argumentuese, rrëfyese, përshkruese, shpjeguese dhe instruktive
<b>Java e tetë:</b>	- Java VIII: Karakteristika gjuhësore të shkrimit akademik
<b>Java e nëntë:</b>	- Java IX: Shkrimi i ë-së
<b>Java e dhjetë:</b>	- Java X: Llojet e fjalive
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	- Java XI: Zgjedhja e leksikut
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	- Java XII: Gjuha e figurshme
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	- Java XIII: Si ta bindim lexuesin?
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	- Java XIV: Dizajni i audiencës
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	- Java XV: Shkarje të zakonshme të normës së shqipes

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët duhet t'i kenë ndjekur së paku 8 nga 15 javët e ushtrimeve për të pasur të drejtë të hyjnë në provim.